



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:127475

Datë: 05.10.2023

Numri i dokumentit: 04756810

P. nr. 73/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. K. nga fshati C., Komuna e M., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/Il.nr.730/23 të datës 23.06.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 10.07.2023, në prezencën e prokurorit të shtetit Kastriot Memaj, të dëmtuarit A. Th., të akuzuarit K. K., së bashku me mbrojtësen e tij Bahrije Xhyliqi avokate në Malishevë, **më 12 korrik 2023, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **K. K.** nga i ati M., e ëma H., e gjinisë G., i lindur më ... nga fshati C., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, atë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, punon në ndërtimtari si punëtor, i pa dënuar më parë, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

I. Me datë 05.06.2023, në rrethe orës 13:15/h, në Rr. "I. M.", në M., saktësisht në kafiterinë "F. C.", i pandehuri me dashje dhe me mjet të rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupore, i shkakton lëndime trupore personit tjetër, këtu të dëmtuarit A. Th., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të atëçastshme, i pandehuri me një çekan në dorë shkon tek kafiteria ku punonte i dëmtuari dhe i drejtohet të dëmtuarit me fjalët "ku është G.", duke iu referuar të dëmtuarit A. Th., pastaj e kap për krahu dhe me të dal poshtë, e nxjerr jashtë në katin e parë të korridorit të kafiterisë dhe pastaj e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me çekan në regjionin e dorës së majtë, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta të bërrylit të dorës së majtë, të përshkruara më gjerësisht sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. F. B., datë 17.06.2023.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 185 par.2 e lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

II. Me datë kohë, dhe vend të njëjtë si në pikën I të dispozitivit, i pandehuri me dashje dhe me mjete të rrezikshme që mund të shkaktojnë lëndim të rënd trupor i shkakton lëndime trupore personit tjetër, këtu të dëmtuarit A. Th., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit A. Th., pasi afrohet i dëmtuari, i pandehuri i drejtohet me fjalët *“kush je ti që ma ke nguc vajzën e vëllait tim”*, dhe e kap për krahu, e nxjerr jashtë kafiterisë si dhe e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me boks në fytyrë dhe me çekan në dorën e djathtë, më ç’ rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë gërvishjtje në mollëzën e fytyrës, të përshkuara më gjerësisht sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. F. B., datë 17.06.2023.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj Gjykata konform nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,69,70,79,185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 242,364,365, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtin e gjykon me:

DËNIM ME BURGIM

Për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit në pikë I, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh.

Për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit në pikë II, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 nën par.2.2 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin e gjykon me **DËNIM UNIK: DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajsh, të cilin dënim është i obliguar që ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në kuadër të dënimit të shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në **PARABURGIM** nga data **05.06.2023 deri 12.07.2023**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20.00 €, për shpenzimet e ekspertizës mjeko-ligjore në shumën prej 20,00 euro, dhe për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50.00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: A. Th. dhe A. Th., që të dy nga fshati Sh., Komuna e Malishevës, lidhur me kërkesat pasurore juridike udhëzohen në kontesti civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.730/2023 të datës 23.06.2023, kundër të akuzuarit K. K. nga fshati C., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 10.07.2023, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, deklaron se: Prokuroria vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë në këtë çështje penale, meqenëse i pandehuri vullnetarisht e pranoi fajësinë dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme më mbrojtësen e tij, po ashtu ky pranim fajësisë gjen mbështetje të plotë në shkresat e lëndës që janë bashkangjitur aktakuzës, andaj i propozoj gjykata që ta pranoi pranimin e fajësisë, ndërsa me rastin e caktimi të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozon gjykatës që si rrethanë lehtësues të merr për bazë faktin se i pandehuri që nga fillimi e ka pranuar përgjegjësinë penale dhe ka pasur qëndrim korrekt në të gjitha fazat e procedurës duke përfshirë dëgjimin në Prokurori, ndërsa si rrethanë rëndues të merret si mënyrë se si është kryer kjo vepër. Sa i përket propozimit të mbrojtës së të pandehurit që të njëjtit ti ndërpritet masa e paraburgimit këtë propozim ia lë në vlerësim të lirë gjykatës.

I dëmtuari A. Th., deklaron se: kërkoj që të dënohet i akuzuari dhe kërkoj kompensim dëmi, ky është rasti im i parë që kam pasur më të akuzuarin sa i përket veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit K. K. av. Bahrije Xhyliqi, deklaron se: pas deklarimit të të mbrojturit tim rrethe deklarimit të fajësisë, unë nuk kam vërejtje për arsyes se pranimi i fajësisë është bere në mënyre vullnetar dhe pas konsultimeve që kemi pasur më të mbrojturin tim, prandaj i propozoj gjykatës që ta merr mendimin e prokurorit të shtetit dhe të pandehurit respektivisht të mbrojturit tim, ta pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat i vihen në barrë, meqenëse se pranimi i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare pa shtytje dhe presion, e gjithashtu edhe duke u mbështetur edhe në provat në aktakuzë dhe provat materiale dhe personale, deklarimit të të mbrojturi tim, si me rastin e ndalimit në Stacionin Policor në M., i cili që në start ka pranuar veprimet e tij, po ashtu edhe

gjatë seancës dëgjimore pranë kësaj gjykate kur i është caktuar paraburgimi si dhe intervistimit të tij para prokurori të rastit, mbrojtja kërkon nga gjykata që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësues me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit sepse të njëjtit e ka bërë në mënyrë vullnetare, e po ashtu duke shprehur keqardhje dhe pendim të thellë që nga fillimi i kësaj procedure gjë të cilën edhe e ka deklaruar, e po ashtu e deklaroi edhe sot, dhe ndaj të mbrojturit tim kërkoj që të zbatohet instituti i zbutjes së dënimit dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim më i butë në kuadër të suazave ligjore e që propozimi i mbrojtjes është një dënim më gjobë apo më kusht.

I mbrojtur im ashtu siç u deklarua është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin nuk ka pas ndonjë të kaluar tjetër të kësaj çështje penale, është i penduar, u kërkon falje të dëmtuarve dhe shpreson që më ta ti rregullon raportet, i premtun gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryen ndonjë veprë penale, është prindër i tre (3) fëmijëve të mitur, më kushte jo të mira materiale dhe më punën e tij siguron të ardhura për jetesë prandaj qëndrimi i tij në paraburgim nga data 05.06.2023, e deri me tani besoj që edhe e ka arritur efektin pozitiv tek i mbrojturi im dhe kërkoj nga gjykata që ti shqyrtoj mundësit ligjore dhe te mbrojturit tim të ia ndërpres masën e paraburgimit dhe të ia jep të drejtën e mbrojtjes në liri.

I pandehuri K. K., deklarohej i fajshëm për të dy veprat penale për të cilat ngarkohem, të njëjtat i pranoj në mënyrë vullnetare, i kërkoj falje të dëmtuarve, ky është rasti im i parë që kam kryer vepra penale, i premtuj gjykatës së nuk do të përsëris veprë tjetër penale.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: CD-ja; ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. F. B. dt.17.06.2023; njësia forenzikës nr. ... dt. 05.06.2023; fillestar i incidenti nr. dt.05.06.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin A. Th. nr. të datës 05.06.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin A.Th.nr. ... të datës 05.06.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin K.K. nr. ... të datës 05.06.2023; foto dokumentacion; raporti i policit A. S.ID#... nr. rastit dt.05.06.2023;Q.K.M.F M. raport mjekësor nr. protokollit ... dt.05.06.2023, për të dëmtuarin A. H. Th.; Q.K.M.F M. raport mjekësor nr. protokollitdt.05.06.2023, për të dëmtuarin A. H. Th., si dhe shkresa tjera të lëndës.

Gjykata me pranimet e fajësive nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimet e fajësive të aprovohen nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimit të fajësisë fillestar nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësitë për veprat penale për të cilat akuzohet, të njëjtat i ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtun Gjykatës se nuk do të përsëris ndonjë vepër tjetër penale dhe do të jetë më i kujdesshëm që të mos kryej vepër tjetër penale, të njëjtat vepra penale i ka kryer për herën e pare. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale për të cilën akuzohet, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprat penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajsh, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.73/2023, datë 12 korrik 2023

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.